VENDIM
Nr. 867, datë 23.12.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 724, DATË 7.12.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, "PËR RINDARJEN ME SHORT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE"

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 1, të nenit 147, dhe në shkronjat "d" dhe "e", të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në shkronjën "d", të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe në pikën 4, të nenit 94, dhe shkronjën "c", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar; në vendimin nr. 724, datë 7.12.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me propozim të tre anëtarëve të Këshillit, Irena Plaku, Gentiana Muçaj dhe Markelian Koça,

VENDOSI:

1. Shtimi i nënpikës 1.1, i nenit 5, i vendimit nr. 724, datë 7.12.2023, si më poshtë:

"1.1. "Neni 5, pika 1, shkronja f (iii) dhe shkronja "g" nuk aplikohen në rastet e gjykatave të shkallëve të para".

2. Ndryshimi i nënpikave 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 7 të vendimit nr. 724, datë 7.12.2023, duke hequr togfjalëshin "*gjykimi i të cilave në shkallë të parë nuk ka filluar*". Neni 7, pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7 riformulohen si më poshtë: "3. *Në rastin e krijimit të seksioneve të reja në gjykatë, çështjet që u përkasin këtyre seksioneve rindahen me short me krijimin e tyre. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e krijimit të seksioneve të reja në gjykatë, si dhe për përcaktimin e çështjeve të regjistruara më parë që do të rishortohen. 4. Në rastin e shtimit të trupave gjykuese në një seksion të gjykatës, çështjet e seksionit ku shtohen trupat gjykues rindahen me short me krijimin e trupave të reja gjykuese. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e shtimit të trupave gjykuese në gjykatë, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e caktuar rishtazi në një seksion të gjykatës, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të këtij seksioni, si dhe të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi, sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë dhe të kategorive të ndryshme. 5. Në rastin e pakësimit të trupave gjykuese në një seksion të gjykatës, çështjet e gjyqtarëve të trupave gjykuese të pakësuar, me daljen e vendimit përkatës të këshillit të gjykatës, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të këtij seksioni. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e pakësimit të trupave gjykuese në një seksion të gjykatës, si dhe për përcaktimin e çështjeve që do të rishortohen. 6. Në rastin e caktimit të gjyqtarit në një seksion tjetër të gjykatës, çështjet e këtij gjyqtari, me caktimin e tij në një seksion tjetër nga këshilli i gjykatës, rindahen me short ndërmjet gjyqtarëve të tjerë të seksionit ku ky gjyqtar bënte pjesë. Në këtë rast rindahen me short vetëm ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat e niveleve më të larta. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e caktimit të gjyqtarit në një seksion tjetër të gjykatës, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarin e caktuar rishtazi në një seksion tjetër, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të seksionit ku caktohet,*

si dhe të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë dhe të kategorive të ndryshme. 7. Në rastin e shtimit të gjyqtarëve në gjykatë, çështjet e gjykatës dhe kur është rasti ato që i përkasin seksionit ku gjyqtarët e ardhur rishtazi caktohen, rindahen me short menjëherë dhe, kur është rasti, me caktimin e këtyre gjyqtarëve në seksione. Në këtë rast rindahen me short Bufer vetëm ato çështje të cilat nuk janë shpallur për gjykim në gjykatat më të larta. Gjyqtarët e ardhur rishtazi, përmes rindarjes me short të çështjeve, ngarkohet me një numër çështjesh jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate apo, kur është rasti, se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të seksionit përkatës të gjykatës në të cilin gjyqtarët e ardhur rishtazi caktohen. Kryetari i gjykatës është autoriteti që vendos për rindarjen me short të çështjeve në rastin e shtimit të Peter gjyqtarëve në gjykatë, si dhe për përcaktimin e rrethit të çështjeve që do të rishortohen, me qëllim që ngarkesa e punës për gjyqtarët e ardhur rishtazi në gjykatë, për aq sa është e mundur, të përfshijë çështje të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre në gjykatë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR KRYETAR
Ilir Rusi